

VËSHTRIM MBI TREGJET

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2016
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar
- *Workshop* “Mbikëqyrja me Bazë Rreziku”
- Takime Pune në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
- Konferenca e 6-të vjetore e EIOPA-s
- Takimi vjetor i Organizatës Evropiane të Certifikimeve Financiare (EFICERT)
- Seminar mbi Mbikëqyrjen *On-site* dhe *Off-site* të Shoqërive Komisionere dhe të Fondeve të Investimit

EDUKIMI I KONSUMATORIT

- Parimet për Përfshirje Inovative Financiare

LAJME NDËRKOMBËTARE

- Bullgari
- Hungari
- Poloni
- Sllovaki

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-shtator 2016 kapën vlerën mbi 10.79 miliardë lekë, ose 7.2% më shumë se gjatë periudhës janar-shtator 2015. Gjatë periudhës janar-shtator 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 808,881 me një ulje prej 0.42% krahasuar me muajin janar-shtator 2015.

Një tjetër tregues i ecures së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 27.82% në krahasim me periudhën janar-shtator 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 1.94 miliardë lekë, apo 65.18% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 7.2% gjatë periudhës janar-shtator 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-shtator 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.65 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2016, duke shënuar një rritje prej 8.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 61.79% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësisë të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.40% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 13.18 % të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës


Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 3.02% krahasuar me periudhën janar-shtator të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 57.16% të

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.65 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2016, duke shënuar një rritje prej 8.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2016

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2016 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 58.32% dhe 26.74% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2016 u dominua në masën 78.12% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 21.88% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.14% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.


Të dhënat statistikore të **tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë** gjatë periudhës janar-shtator 2016 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 58.32% dhe 26.74% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.42% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
Periudha janar-shtator		2015	2016	'16/'15-1
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	5,407.75	4,632.77	(14.33)
	<i>Individë</i>	4,386.50	3,838.87	(12.48)
	<i>Persona juridikë</i>	1,021.26	793.90	(22.26)
C	Blerje para afatit të maturimit	1,934.21	2,863.99	48.07
	<i>Individë</i>	1,860.81	2,382.09	28.01
	<i>Persona juridikë</i>	73.40	481.90	556.54

Letra me Vlerë të Qeverisë 2016



Transaksioni i llojit B "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" gjatë periudhës janar-shtator 2016, ka pasur një ulje prej 775 milionë lekë ose 14.33% krahasuar me periudhën janar-shtator 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 10.31%.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" gjatë periudhës janar-shtator 2016, ka pasur një ulje prej 775 milionë lekë ose 14.33% krahasuar me periudhën janar-shtator 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 10.31%.

Transaksioni i llojit C "Blerje para afatit të maturimit" gjatë periudhës janar-shtator 2016 ka pasur një rritje prej 930 milionë lekë ose 48.07% krahasuar me periudhën janar-shtator 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 41.44%.

Krahasuar me periudhën janar-shtator 2015, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 155 milionë lekë.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi priti në datën 26 tetor përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadër të misionit të tyre të radhës që u zhvillua në datat 20 tetor deri në 2 nëntor 2016. Misioni i FMN-së u përfaqësua në këtë takim nga Z. Ezequiel Cabezon, Departamenti për Evropën.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Znj. Shehi bëri një prezantim të zhvillimeve të fundit si dhe të progresit të arritur në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, përmes strategjisë së rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, inspektimeve të plota dhe tematike, duke ju përgjigjur zhvillimeve të tregut financiar me mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun.

Mundësitë e zhvillimit të tregjeve dhe arritja e mbikëqyrjes së konsoliduar në bashkëpunim me autoritete të tjera rregullatore brenda dhe jashtë Shqipërisë ishin çështje të tjera që u diskutuan në këtë takim.

Zhvillimi i tregjeve në mbikëqyrje të AMF-së, forcimi i kapaciteteve, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe sfida në krijimin e një kuadri për menaxhimin e krizave financiare, do të jenë në fokus dhe në ndjekje nga Banka Botërore dhe FMN.

Workshop “Mbikëqyrja me Bazë Rreziku”

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*), Banka Botërore, si edhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e Maqedonisë organizuan në datat 6-7 tetor në Ohër, Maqedoni *workshop-in* me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku”. Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga EIOPA, Banka Botërore dhe agjencitë e mbikëqyrjes së sigurimeve nga vende si Austria, Gjermania, Lituania, Moldavia, Maqedonia, Rumania, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia.

Temat kryesore që u trajtuan në *workshop* u prezantuan nga ekspertë të fushës së Bankës Botërore dhe EIOPA. Në ditën e parë të *workshop-it* u prezantua një pasqyrë mbi mbikëqyrjen në tregut të sigurimeve, duke u përqendruar në metodologjinë e re të riskut. Kjo metodologji paraqet një kategorizim të ri të shoqërive të sigurimit, praktika krahasuese (*benchmarks*), si dhe faktorët e riskut. Kjo mënyrë e re mbikëqyrjeje ka për qëllim të jetë e kujdesshme, si dhe interaktive. Në vijim, ekspertët e panelit paraqitën praktikën e tyre lidhur me përzgjedhjen e drejtuesve të shoqërive për aspektet e integritetit, besueshmërisë dhe testimit të arsyeshmërisë

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Znj. Shehi bëri një prezantim të zhvillimeve të fundit si dhe të progresit të arritur në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, përmes strategjisë së rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, inspektimeve të plota dhe tematike, duke ju përgjigjur zhvillimeve të tregut financiar me mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun.

Në këtë konferencë u fol edhe për krijimin e një tregu të vetëm për pensionet private i cili është dhe një nga përfitimet kryesore të BE-së.

dhe përshtatshmërisë. Më tej *workshop-i* trajtoi sfidat që hasen në sektorin e sigurimeve në rajon.

Gjatë *workshop-it* u diskutua edhe mbi vlerësimin e aseteve dhe detyrimeve në regjimin e *Solvency II* (menaxhimi i riskut dhe kërkesat për zbulimin e informacionit). Ngritja e metodologjisë së mbikëqyrjes bazuar në identifikimin e vlerësimin e rreziqeve të siguruesve dhe profilet e rrezikut të siguruesve e përafron metodologjinë mbikëqyrëse me atë vendeve të Bashkimit Evropian.

Në përfundim, të *workshop-it* në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve, u prezantuan praktikatat e mbikëqyrjes së Bankës Botërore. Me anë të përfshirjes së EIOPA-s dhe udhëzimeve të saj po punohet në çështje si shkëmbimi i informacionit, pjesëmarrja dhe vlerësimi i përbashkët i rrezikut.

Konferenca e 6-të vjetore e EIOPA-s

Më datë 18 tetor 2016, në Frankfurt të Gjermanisë u zhvillua Konferenca e 6-të vjetore e EIOPA-s e titulluar “Eksplorimi i horizonteve të reja”.

Konferenca organizohej nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*). Në këtë konferencë u diskutua mbi sfidat e mbikëqyrjes sipas *Solvency II*, direktivë e cila solli një ndryshim shumë të madh në aspektin financiar, organizativ, ligjor dhe operacional në industrinë e sigurimeve.

Për vetë rëndësinë që marrin pensionet private në zhvillimin e tregut të kapitalit të vendeve të BE-së, si dhe nevoja për heqjen e barrierave midis vendeve të BE-së bazuar në direktivën e IORP II, në këtë konferencë u fol edhe për krijimin e një tregu të vetëm për pensionet private, i cili është dhe një nga përfitimet kryesore të BE-së. Në këtë kuadër u diskutua për hedhjen në treg të produktit PEPP (*Pan European Personal Pension Product*). PEPP mund të kthehet në një katalizator për fitimet nga rritja e efikasitetit përmes ekonomisë së shkallës, mundësive për diversifikimin e rrezikut, konkurrencës dhe inovacionit për të mirën e konsumatorëve.

Gjithashtu u diskutua dhe për transformimin digjital në sektorin e sigurimeve. Ky transformim do të rrisë transparencën dhe thjeshtësinë në të gjithë tregun e brendshëm për konsumatorët, por në të njëjtën kohë u fol edhe për mbrojtjen dhe pronësinë e të dhënave të përdoruesve. Në qendër të kësaj konferencë ishin produktet e reja, të cilat mund të transformojnë tregun e sigurimeve si *cyber insurance* apo automjetet e komanduara.

Takimi vjetor i Organizatës Evropiane të Certifikimeve Financiare (EFICERT)

Institutet kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve të organizatave anëtare të Bashkimit Evropian por jo vetëm, takohen një herë në vit për të ndarë zhvillimet në tregun vendas për sa i

Në këto takime u theksua nevoja e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të informacionit midis AMF-së dhe BQK-së. Ato shërbyen gjithashtu për të vendosur linjat e komunikimit shumë të nevojshme mes Departamenteve të Mbikëqyrjes për mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet rregullatorëve.

përket arsimimit dhe edukimit në tregun e sigurimeve, për të shkëmbyer përvojën dhe për të identifikuar standardet e përbashkëta të njohurive dhe kompetencave në nivelet e përcaktuara për ndërmjetësit në sigurime në nivel ndërkombëtar. Në konferencë punohet për të arritur një homogjenitet më të madh për sa i përket edukimit profesional dhe programeve me provimet përkatëse në tregun e sigurimeve.

Për sa i përket zbatimit të rregullores së re të IDD (*Insurance Distribution Directive*), në interes edhe të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë konferencës u diskutuan ndryshimet e vërejtura në përkthimin e direktivës në nivele kombëtare. Gjithashtu u diskutuan gjetjet e një pyetëso, i cili ishte plotësuar më parë nga të gjithë pjesëmarrësit në formë elektronike, me qëllim që të përdoret Organizata Evropiane e Instituteve Kombëtare për Edukimin në Sigurime, si një sistem i njohjes së ndërsjellë të certifikatave kombëtare të formimit profesional në këtë fushë.

Ky event u organizua nga Instituti i Sigurimeve të Qipros, më datat 12 - 14 tetor në Nikosia, me mbështetjen e Organizatës Evropiane të Instituteve Kombëtare për edukim në sigurime dhe kishte për qëllim të sjellë së bashku përfaqësues të instituteve kombëtare të tregut të sigurimeve nga vende evropiane por jo vetëm, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe përvojave në çështjet e edukimit në tregun e sigurimeve.

Takime pune në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Në datat 20 dhe 21 tetor 2016 një grup pune nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i përbërë nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Përgjegjësi i Sektorit në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, kreu një vizitë pune në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Synimi i vizitës ishte rritja e bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve dhe në veçanti për t'u informuar me gjendjen financiare të shoqërive që janë pjesë e grupeve të sigurimit në Shqipëri.

Gjatë qëndrimit në Kosovë ekipi nga AMF u takua me Zv. Guvernatorin e BQK-së, Drejtorin e Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Drejtorin e Divizionit të Raportimit dhe Analizës.

Në këto takime u theksua nevoja e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të informacionit midis AMF-së dhe BQK-së. Ato shërbyen gjithashtu për të vendosur linjat e komunikimit shumë të nevojshme mes Departamenteve të Mbikëqyrjes për mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet rregullatorëve me synim koordinimin e një mbikëqyrjeje efektive në të mirë të arritjes së objektivit për ruajtjen e shëndetit financiar të shoqërive që mbikëqyrin dhe në këtë mënyrë mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve.

Në përfundim, u diskutua edhe për mundësitë e planifikimit të një inspektimi të përbashkët gjatë vitit 2017 në një nga shoqëritë e sigurimit të licencuar në Kosovë që është pjesë e një prej grupeve të sigurimit në Shqipëri, si dhe shkëmbim të informacionit dhe eksperiencave të nevojshme për të dy palët.

Seminar mbi Mbikëqyrjen *On-site* dhe *Off-site* të shoqërive komisionere dhe të fondeve të investimit



Pjesëmarrësit e seminarit me temë : “Mbikëqyrja *On-site* dhe *Off-site* e shoqërive komisionere dhe e fondeve të investimit.”

Krahas tematikave me interes në mbikëqyrjen e tregjeve të fondeve të investimeve dhe shoqërive komisionere, seminari krijoi edhe mundësinë e krijimit të një *network-u* midis profesionistëve pjesëmarrës në këtë seminar.

Në datat 26-28 tetor 2016 në Varshavë, Poloni u zhvillua seminari me temë “Mbikëqyrja *On-site* dhe *Off-site* e shoqërive komisionere dhe e fondeve të investimit”. Seminari ishte organizuar nga Iniciativa për Trajnim e Mbikëqyrje Financiare (*Training Initiative for Financial Initiative, TIFS*) e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë (KNF). TIFS është një qendër trajnimi për mbikëqyrësit e të gjithë tregjeve financiare (për bankat, tregjet e kapitalit, të pensioneve dhe sigurimeve) e krijuar nga KNF.

Seminari ishte i organizuar me sesione prezantimesh, diskutimesh nga pjesëmarrësit, si edhe me raste konkrete mbi tematika të ndryshme.

Çështjet kryesore që u trajtuan ishin si më poshtë:

- Licencimi i shoqërive komisionere, ku u trajtuan çështje praktike dhe raste konkrete të licencimit, verifikimi i kërkesave ligjore dhe organizative, konfliktet e interesit, mbrojtja e investitorëve;
- Mbikëqyrja *On-site* dhe *Off-site* e shoqërive komisionere dhe e fondeve të investimit, ku u trajtuan çështje praktike dhe raste konkrete të mjeteve kryesore të mbikëqyrjes së vazhdueshme, procedurat e mbikëqyrjes, risku i ekspozimit i lidhur me UCITS (*Undertakings for Collective Investment in Transferable Securities*), sfidat e inspektimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme;
- Procedimet administrative dhe kriminale të lidhura me shoqëritë komisionere dhe fondet e investimit, ku u trajtuan raste konkrete të ndodhura dhe masat e marra në kuadër të mbrojtjes së investitorëve.

Ky seminar krahas tematikave me interes në mbikëqyrjen e tregjeve të fondeve të investimeve dhe shoqërive komisionere, krijoi edhe mundësinë e krijimit të një *network-u* midis profesionistëve pjesëmarrës në këtë seminar.

Parimet për përfshirje inovative financiare

<http://www.g20.utoronto.ca/2010/to-principles.html>



Mjedisi rregullator që krijon mundësitë, përcakton edhe shpejtësinë me të cilën ngushtohet dhe mbyllet hendeku në shërbimet financiare për më shumë se dy miliardë njerëz në botë të cilët për momentin janë të përjashtuar.

Përfshirje inovative financiare do të thotë përmirësim i aksesit në shërbimet financiare për njerëzit e varfër, nëpërmjet përhapjes së sigurtë të qasjeve të reja. Parimet e mëposhtme kanë për qëllim të ndihmojnë krijimin e një politike të përshtatshme dhe një mjedisi rregullator për përfshirje inovative financiare. Mjedisi rregullator që krijon mundësitë, përcakton edhe shpejtësinë me të cilën ngushtohet dhe mbyllet hendeku në shërbimet financiare për më shumë se dy miliardë njerëz në botë të cilët për momentin janë të përjashtuar. Këto parime për përfshirje inovative financiare janë krijuar bazuar në përvojat dhe mësimet e nxjerra nga politikëbërësit në të gjithë botën, sidomos nga liderët e vendeve në zhvillim.

Udhëheqja: Nxisni një angazhim me bazë të gjerë të qeverisë për përfshirjen financiare për të ndihmuar në zbutjen e varfërisë.

Diversiteti: Zbatoni politika që nxisin konkurrencën dhe sigurojnë stimuj të bazuar në mekanizmat e tregut. Ato do të ofrojnë mundësinë për akses të qëndrueshëm financiar dhe përdorim të një game të gjerë të shërbimeve të përbalueshme (kursimet, kreditë, pagesat dhe transfertat, policat e sigurimit), si dhe një shumëllojshmëri të ofruesve të shërbimeve.

Inovacioni: Promovoni risi teknologjike dhe institucionale si një mjet për të zgjeruar aksesin në sistemin financiar dhe përdorimin e këtij sistemi, duke u kujdesur edhe për zgjidhjen e mangësive në infrastrukturë.

Mbrojtja: Inkurajoni një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e konsumatorit, e cila i jep rol edhe qeverisë ashtu sikurse edhe ofruesve të konsumatorëve.

Fuqizimi: Zhvilloni edukimin financiar dhe aftësitë financiare.

Bashkëpunimi: Krijoni një mjedis institucional me linja të qarta të përgjegjshmërisë dhe koordinimit brenda qeverisë dhe gjithashtu inkurajoni partneritet dhe konsultime të drejtpërdrejta me qeverinë, biznesin dhe aktorët e tjerë të grupeve të interesit.

Njohuri: Shfrytëzoni të dhëna të përmirësuara për të bërë politika të bazuara në fakte dhe informacione, për të matur progresin dhe shikoni mundësinë e përdorimit të qasjes “testo dhe mëso” qasje që të jetë e pranueshme si për rregullatorin ashtu edhe ofruesin e shërbimit.

Proporcionaliteti: Ndërtoni një politikë dhe kornizë rregullative që është në proporcion me rreziqet dhe përfitimet e përfshira në produktet dhe



Këto parime janë një pasqyrim i kushteve për nxitjen e inovacionit në përfshirjen financiare duke mbrojtur gjithashtu edhe stabilitetin financiar dhe konsumatorët.

shërbimet e tilla të reja, e cila është e bazuar në kuptimin e mangësive dhe pengesave në rregullat ekzistuese.

Korniza rregullatore (Framework): Në kuadrin rregullator duhen reflektuar standardet ndërkombëtare, rrethanat kombëtare dhe mbështetja për një mjedis konkurrues. Ai duhet të përfshijë:

- Një regjim të përshtatshëm, fleksibël, të bazuar në rrezik kundër pastrimit të parave dhe luftën ndaj financimit të terrorizmit;
- Kushtet për përdorimin e agjentëve si ndërlidhës me konsumatorët (*customer interface*);
- Një regjim të qartë rregullator për vlerat (informacionet, të dhënat) e ruajtura në mënyrë elektronike;
- Stimuj të bazuar në mekanizmat e tregut për të arritur qëllimet afatgjatë për një ndërveprim dhe ndërlidhje të gjerë.

Këto parime janë një pasqyrim i kushteve për nxitjen e inovacionit në përfshirjen financiare duke mbrojtur gjithashtu edhe stabilitetin financiar dhe konsumatorët. Ato nuk janë një grup i ngurtë i kërkesave, por janë të hartuara për të udhëzuar politikëbërësit në procesin e vendimmarrjes. Ato mund të përshtaten si për rrethana ashtu edhe për vende të ndryshme.

Bullgari

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare (FSC) i Bullgarisë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 tregu i sigurimeve arriti vlerën e 528.15 milionë euro, me një rritje të primeve të shkruara bruto prej 5.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dy ishin segmentet e biznesit me kontribut më të madh në rritjen e tregut: sigurimi i Jetës me rritje prej 44% sidomos për produktet e lidhura me skemat e investimeve; si edhe sigurimet e automjeteve (sigurimi CASCO dhe MTPL).

Sigurimi i Jo-Jetës pati një rritje prej 4.4% të primeve të shkruara bruto. Primet e sigurimit motorik u rritën me 6.25% duke arritur në 292 milionë euro. Kjo rritje lidhet edhe me ritmet e rritura në shitjet e makinave, megjithëse ato kishin një ritëm më të ulët se sa në vitin 2015. Një tjetër faktor nxitës ishte edhe rritja e kreditimit bankar.

Sigurimi MTPL ka ruajtur trendin pozitiv me një rritje 5.5% të primeve të shkruara bruto. Megjithatë, edhe dëmet e paguara u rritën, madje edhe në një ritëm më të lartë, prej 21%. Kjo ishte pjesërisht edhe si rezultat i hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Sigurimeve i cili parashikon ndër të tjera edhe kufij më të lartë mbulimi për rastet e vdekjeve në rrugë dhe lëndimeve trupore.

Sigurimi i pronës ka ngelur në një nivel shumë të ulët dhe madje gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 pati një rënie 3.8% të primeve të shkruara bruto, pavarësisht ngjarjeve natyrore të vështira, motit të keq i cili preku gjithë vendin. Pagesat e dëmeve u ulën me rreth 27% në krahasim me vitin 2015.

Hungari

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun hungarez të sigurimeve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 arritën vlerën e 1.45 miliardë euro, me një rritje 2.8% krahasuar në terma vjetore. Sigurimet e Jo-Jetës ishin udhëheqësi kryesor i rritjes së tregut, sidomos për shkak të rritjes dyshifrore në sigurimet MTPL.

Primet e sigurimit të Jetës u ulën me 2.8%, duke arritur në 699.13 milionë euro, kryesisht si rezultat i rënies me pothuajse 17% të primeve të regjistruara për produktet e lidhura me skemat e investimit, të cilat janë produktet që kapin pjesën më të madhe të tregut. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se të dhënat e viteve 2015 dhe 2016 nuk janë krejtësisht të krahasueshme. Banka Kombëtare Hungareze në fillim të vitit 2016 ka ndryshuar standardin e raportimit duke vënë në zbatim kërkesat e Solvency II e cila ka rishqyrtuar disa nga klasifikimet e policave të sigurimit. Kështu për

shembull, produktet e lidhura me skemat e investimeve, si produkte të kursimeve pensionale, bazuar në një regjim tjetër tatimor, tashmë janë konsideruar në një kapitull të veçantë.

Sigurimi i Jo-Jetës pati tendencë pozitive si në linjat e sigurimit të pronës ashtu edhe në sigurimin motorik.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e pronës u rritën me 4.1%, duke arritur në 284.4 milionë euro. Edhe klasat e sigurimeve motorike shënuan tendenca pozitive, me rritje të primeve të shkruara bruto prej 23%, duke arritur në 342.7 milionë euro. Linjat e sigurimit MTPL patën një rritje prej gati 33%, duke u mbështetur nga rritjet në shitjen e makinave dhe sidomos nga rritja e tarifave të MTPL-së. Sipas mediave lokale në Hungari, çmimet e MTPL-së u rritën me 20-30% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.

Poloni

www.xprimm.com

Pas një viti thuajse të qëndrueshëm gjatë vitit 2015, tregu polak i sigurimeve e përfundoi gjysmën e parë të vitit 2016 me një rënie 8% të primeve të shkruara bruto e krahasuar në terma vjetore, e cila ishte tërësisht e drejtuar nga rënie e tregut të sigurimit të Jetës.

Sigurimi i Jetës pati një rënie prej 21.7% të primeve të shkruara bruto në terma vjetorë, duke arritur në 2.69 miliardë euro, duke humbur kështu rreth 7.5 pp (pikë përqindje) të peshës së tij në treg. Të dy klasat kryesore të sigurimit të Jetës kanë pasur një prirje të fortë zbritëse. Sikurse u shpreh për Xprimm z. J. Grzegorz Pradzynski, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Siguruesve Polakë, trendi negativ është kryesisht një pasojë e ndryshimeve rregullative.

Linjat e sigurimit të Jo-Jetës patën një zhvillim pozitiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, me rritje të primeve të shkruara bruto prej 6.45% në terma vjetore duke arritur në 3.47 miliardë euro. Megjithatë, jo të gjitha linjat e sigurimit të Jo-Jetës patën të njëjtën tendencë pozitive.

Linjat e sigurimit të pronës patën një rënie prej 3.3% të primeve të shkruara bruto, shumica e të cilave vinte nga sigurimet nga «zjarri». Megjithatë, është interesante të vihet re se, sipas të dhënave zyrtare statistikore të ofruara nga autoriteti rregullues i tregut, numri i kontratave të sigurimit nga zjarri u rrit në krahasim me gjysmën e parë të viti 2015.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 kishte edhe një rritje të dëmeve të paguara për sigurimin e pronës, veçanërisht për klasën «dëmtime të tjera të pronës», për të cilën dëmet e paguara u rritën me 139%, sidomos pas dëmtimeve të rënda të kulturave bujqësore të shkaktuara nga ngricat e mëdha të vitit.

Edhe klasat e sigurimit motorik MTPL dhe Kasko, shënuan tendenca pozitive në volumin e primeve të shkruara bruto.

Slovakia

www.xprimm.com

Siguruesit slovake në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 arritën një volum të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto më të vogël se ato në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Sipas përfaqësuesve të tregut të sigurimeve, duke pasur parasysh stabilitetin e tregut slovak gjatë viteve të fundit, parashikohet që rezultatet e tregut në fund të vitit duhet të jenë pak a shumë të përafërta me rezultatet e vitit 2015.

Megjithatë, krahasimi me vitin e kaluar, duhet të konsiderohet me kujdes pasi duke filluar që nga 1 janari 2016 siguruesit slovake kërkojnë të raportojnë të dhënat në përputhje me standardet e *Solvency II*, të cilat në disa raste sigurojnë klasifikime të ndryshme të linjave të biznesit, duke çuar kështu në ndryshime.

Një sfidë tjetër e rëndësishme e cila duhet të merret në konsideratë është një ndryshim i fundit në sistemin e tatimeve indirekte mbi primet e sigurimit të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme si siguruesit ashtu edhe konsumatorët.

The logo for the Albanian Financial Markets Authority (AMF) features the lowercase letters 'amf' in a dark red color, followed by the word 'ALBANIA' in white uppercase letters. The 'amf' is positioned within a light gray rectangular box, and 'ALBANIA' is within a larger light gray rectangular box to its right.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al